



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 453/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Muharrem Shala dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Drita Kelmendi-Kukaj nga Peja, kandidatë për deputete për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 03.07.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Drita Kelmendi-Kukaj kandidatë për deputete për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 01.07.2014, nga Drita Kelmendi-Kukaj në cilësinë e kandidates për deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, në të cilën pretendon se është bërë konstatim jo i plotë dhe i gabuar i gjendjes faktike për shkak të numërimit jo të drejtë të votave nga ana e komisionerëve të subjektit politik AAK. Më tutje parashtresja e ankesës pretendon se nga informatat të besueshme posedon më shumë vota se sa janë shpallur me rastin e publikimit të rezultateve përfundimtare në këto Vendvotime (VV): 1706c/01/03/04/05/07, 1702c/02, 1713c//02//03/06, 1725c/01, 1707c/06/07, 1712c/03, 1727-c/03, sipas parashtresës së ankesës komisionerët e subjektit politik AAK, kanë bërë manipulime dhe votat e saj i kanë adresuar kandidatëve të tjerë të po këtij subjekti.

Po ashtu parashtresja e ankesës ka kërkuar nga PZAP-i, ta aprovoj ankesën e saj dhe të urdhëroi rinumërimin e të gjitha atyre vendvotimeve në të cilat ka pretenduar se ju ka bërë e padrejtë gjatë numërimit të votave.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore se ju kanë manipuluar votat me rastin e numërimit nga komisionerët e subjektit politik AAK janë të pabazuara ngase parashtruesja e ankesës nuk e ka ofruar asnjë dëshmi për ta vërtetuar një pretendimet të tillë të parashtruar në ankesë.

Ndërsa lidhur me atë që parashtruesja e ankesës ka kërkuar që të rinumërohen të gjitha VV e theksuar në ankesë PZAP-i e konstaton si të pabazë sepse parashtruesja e ankesës nuk ka ofruar asnjë dëshmi, kopje të ndonjë dokumentacioni relevant apo dëshmi tjera në posedim të ankuesit siç edhe kërkohet në bazë të nenit 3.6 pika (c) e Rregullave dhe Proceduarave të PZAP-it. Për më tepër parashtruesja e ankesës vetëm ka pretenduar se i mungojnë votat në VV e potencuara në ankesë por në asnjë rast nuk ka theksuar se sa vota i mungojnë nëpër VV e përmendura andaj PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar, në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 453/2014 më datën 03.07.2014



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*